



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU	
Nr.faq/Br.shr.		162
Datë/Data:		22.10.2019
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE		



Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e dhjetë X-të, e rregullt e Kuvendit të Komunës, e mbajtur më datë 26.09.2019, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Remzi Shala, Ilir Hasani, Arjeta Jashari, Mirvete Gërguri, Jetmir Berisha, Albert Jasharaj, Miranda Shabani, Sabit Bullatovci, Sabri Rexhepi, Ali Zogiani, Betim Ahmeti, Durim Hajra, Eglantina Azemi, Doruntina Jashari, Aida Alimi, Arjana Zogiani, Naser Graiçevci, Migjen Kolshi, Mehdi Lahu, Shaban Ademi, Driton Ademi, Ali Ismaili, Driton Hasolli, Hysni Hasani, Bashkim Krasniqi dhe Ljubisa Qirkoviq.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Fadil Krasniqi - Nënkryetar i Komunës, Ramadan Jashanica - Drejtor i Financave dhe Buxhetit, Nuriye Fazliju - Drejtore e Administratës dhe Nuriye Avdiu - Drejtore e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Të tjerë: Përfaqësuesit e OSBE-së.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, të datës 26.06.2019 dhe 25.07.2019.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Propozim për shqyrtimin e Buxhetit të Planifikimit për vitin 2020.
4. Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës për periudhën janar/qershor 2019.
5. Propozim për shqyrtimin e Raportit Financiar për buxhetin e shpenzuar për periudhën janar/qershor 2019
6. Raporti i Auditimit të Jashtëm për vitin 2018 në Komunën e Fushë Kosovës.
7. Informatë e Drejtorisë së Arsimit për fillimin e vitit shkollor 2019-2020.
8. Të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes, më pas lexoi pikat e rendit të ditës të parapara për shqyrtim në mbledhjen e sotme, me 'Informatën e Drejtorisë së Arsimit për fillimin e vitit shkollor 2019-2020' dhe hapi diskutimin.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', një 'kundër' dhe dy abstenime, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi për shqyrtim rendin e ditës së propozuar, me 'Informatën e Drejtorisë së Arsimit për fillimin e vitit shkollor 2019-2020'.

Durim Hajra: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Materiali për shqyrtim në mbledhjen e sotme është voluminoz, është dashur që të na dërgohet edhe në mënyrë elektronike, në mënyrë që të mos ketë vonesa.

Pika e një (1) - Aprovimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të datës 26.06.2019 dhe 25.07.2019.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: I kemi për aprovim, ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më datë 26.06.2019 dhe 25.07.2019, nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim për diskutimet tuaja.

Pas që vërejtje apo sugjerime për përmbajtjen e ekstrakteve të procesverbaleve nuk pati nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës i qiti për votim në pako ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të mbajtura më datë: 26.06.2019 dhe 25.07.2019.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', shtatë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e dy anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave i aprovoi ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të mbajtura më datë: 26.06.2019 dhe 25.07.2019.

Pika e dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare'. Hap diskutimin.

Durim Hajra: Në realizimin e projekteve kapitale në qytetin e Fushë-Kosovës ka mungesë të mbikëqyrjes së punimeve që kryhen nga kompanitë, po ashtu edhe rezultati dhe cilësia e punimeve të trotuarit është e dobët, punimet janë bërë shkel e shko ka shumë vonesa në rregullimin e trotuareve ku mungon shenjëzimi, janë shpenzuar 100,000.00€ për trotuare, ndërsa janë shtruar shumë pak metra në rrugën 'Dardania' dhe në lokacionet tjera nëpër fshatra. Shembull tipik i punës së dobët është asfaltimi në rrugën 'Hajrullah Zymi' në Fushë-Kosovë, e cila është asfaltuar me 3 korrik dhe më 21 korrik janë hapur gropat, e njëjta vlen edhe për rrugët tjera siç është rruga 'Pajazit Islami' ku trotuari është bërë, por nuk është funksional. Ne kërkojmë që lidhur me këto punime të kemi sqarime. Pyes, pse pranohen punët në këtë mënyrë?

Mehdi Lahu: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë i kam dy shqetësime, në rrugën 'Nëna Terezë' e cila është rregulluar para pesë muajve, prapë ka prerje të rrugës dhe janë hapur disa gropat. Probleme ka pasur edhe në rrugën anësore 'Shukrie Obërtinca', ku kompania punë kryese nuk i ka rregulluar vendet e ujë mbledhjes së kanalizimeve dhe banorët aty janë të shqetësuar, sepse kur ka të reshura, uji i shirave vërshon sikur në kohën e dimrit. Banorët e kësaj rruge do të ngritin edhe padi, nëse nuk ndërmerret diçka. Njësoj rrjedh uji edhe para mobilierisë 'Prishtina'

andaj ne kërkojmë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit që të ndërmerren masa për sanimin e gjendjes.

Migjen Kolshi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një pyetje për Drejtorinë e Administratës. Mikrofonat në sallën e Kuvendit të Komunës nuk punojnë as pas një viti, ju këtë punë keni mundur ta siguronit me garancionet për sigurimin e tenderit dhe nëse kjo punë nuk funksionon në atë mënyrë, duhet të rregullohet në një mënyrë tjetër, e jo të mbetet e pazgjidhur me vite.

Ali Ismaili: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne nuk kemi marrë përgjigje për pyetjet e parashtruara në muajin korrik, e njëjta vlen edhe për pesë vitet e kaluara dhe kjo ndikon në demotivimin tonë për parashtrimin e pyetjeve. Megjithatë, unë do ta parashtroj një pyetje lidhur me rrugën 'Pajazit Islami', ku kompania 'Menda' është duke ndërtuar një objekt të madh dhe nuk ka leje ndërtimi. Këtu duhet të veprojnë institucionet përgjegjëse, inspektorati i ndërtimit, policia e shtetit, prokuroria e shtetit, sepse aty është duke u ndërtuar sikur në xhungël. E dyta, banorët nuk i dinë të gjitha procedurat, blejnë banesa me probleme, për të cilat u thuhet se do të trajtohen përmes procesit të legalizimit. Ne kërkojmë që ndërtimet të bëhen në përputhje me Projekt-Hartën Zonale të Komunës. Ndërtimi është duke u bërë nga fqinji im në mënyrë jo të mirë, ne tani jemi njëzet vite pas luftës dhe na duhet të reagojmë në mënyrën më të vështirë për palët, kur nuk reagojnë organet e shtetit. Unë e ftoj inspektoratin që të dal në vend ngjarje dhe ta zgjidh këtë çështje, ose duhet të reagojmë përmes mediave për t'i ndaluar punimet aty. Ndërtimi është një metër afër shtëpisë sime, unë këtë problem do ta ndjek edhe përmes prokurorisë, nëse përgjegjësit nga komuna nuk ndërmarrin masat e nevojshme.

Aida Alimi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë kam qenë pjesë e punës në Komisionin për emërtimin e rrugëve, ku i kemi evidentuar 75 ankesa të qytetarëve të dorëzuara për shqyrtim në vitin 2014 dhe 2015. Aty kanë munguar kërkesat për vitet tjera, madje edhe kërkesa të cilën e kam parashtruar unë.

Driton Hasolli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Punimet në trotuar janë kryer me cilësi të dobët, po ashtu edhe mbjellja e drurëve dekorativ është bërë në mënyrë jo të përshtatshme. Unë mbjelljen e pemëve e kam shikuar edhe në komunën e Obiliqit, ku është punuar më mirë. Andaj kërkoj që kur t'i realizojmë projektet publike ato të bëhen sipas standardeve më të mira të kohës.

Nënkryetari i Komunës: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në rrugën 'Dardania' punimet nuk kanë përfunduar. Ne e dimë se ka disa probleme, por ato do të rregullohen në periudhën e ardhshme. Ju duhet ta dini se ajo zonë e qytetit është në ndërtim e sipër, aty kalojnë kamionët dhe asfalti në kohën e verës dëmtohen. Lidhur me objektin që po ndërtohet nga kompania 'Menda' ne i kemi procesverbalet për ndalimin e punimeve, lidhur me këtë çështje do ta keni një përgjigje, ne do të veprojmë sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Drejtorja e Administratës: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Kur jemi vendosur në objektin e ri të komunës ka pasur disa probleme. Objekti është ndërtuar nga kompania e kontraktuar nga Komisioni Evropian, ne i kemi ndarë 30,000.00€ për rregullimin e sallës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2019 i kemi të planifikuara edhe 5,000.00€ për digjitalizimin e votimit në sallën e

Kuvendit të Komunës. Ne i'u kemi dërguar emaila për këtë punë përfaqësuesve të kompanisë, por ky proces nuk varet nga ne.

Driton Ademi: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Pyes, a do të rregullohet kjo punë brenda mandatit tonë? Edhe ne si asamblistë mund të participojmë për krijimin e kushteve më të mira për punë, por ju duhet ta vendosni në ueb-faqe qëndrimin tonë lidhur me këtë çështje.

Nënkryetari i Komunës: Ne si komunë nuk e kemi pasur të drejtën e kontraktimit, andaj jemi të detyruar që të presim sepse ata nuk lejojnë që të intervenohet. Çështja e mjeteve financiare nuk është problem, por aspekti procedural i ndërhyrjes në përfundimin e punës së kontraktuar nga dikush tjetër.

Pika e tretë (3) - Propozim për shqyrtimin e Buxhetit të Planifikuar për vitin 2020.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Buxhetin e Planifikuar për vitin 2020, i cili përfshinë projekte publike investive në secilin fshat dhe lagjet e qytetit, është gjithëpërfshirës. Ftoi Drejtorin e Financave dhe Buxhetit që të na jap sqarime.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Buxheti i Komunës për vitin 2020, është hartuar duke u mbështetur në Qarkoren Buxhetore numër 1, të Ministrisë së Financave, është miratuar Korniza Afatmesme Buxhetore në muajin qershor, janë mbajtur tri dëgjime buxhetore, numri i qytetarëve në dy dëgjetet e para publike ka qenë i kënaqshëm, në dëgjime kanë marrë pjesë edhe asamblistët Durimi dhe Migjeni. Në buxhetin për vitin 2020 grandit qeveritar është në shumë prej 9,798,856.00€, të hyrat vetjake janë në shumë prej 2,809,510.00€, ndërsa në total buxheti është në shumë prej 12,608,366.00€, ndërsa nëpër kategoritë ekonomike është si vijon: për paga dhe mëditje është në shumë prej 5,602,345.00€, për mallra dhe shërbime është në shumë prej 1,601,707.00€, për shpenzime komunale është në shumë prej 230,000.00€, për subvencione dhe transfere është në shumë prej 299,657.00€ dhe për projekte kapitale është në shumë prej 4,874,657.00€. Kemi një rritje të buxhetit të komunës prej 8.8%.

Durim Hajra: Buxheti i planifikuar për vitin 2020 është një kopje. Ka mungesë të kreativitetit dhe ideve, për përmbushjen e nevojave është duke u vazhduar me formën e vjetër të hartimit të buxhetit. Unë kam qenë pjesëmarrës në tri dëgjetet buxhetore, i kam paraqitur disa propozime prej të cilave vetëm dy janë përfshirë në buxhet. Kërkesat e fshatrave Miradi e Epërme dhe Lismir të cilat janë ndihmuar nga një organizatë nuk janë të përfshira në buxhet. Pas njëzet vjetëve mungon uji i pijshëm, rrjeti i kanalizimit nuk e përballon ndërtimin e ri, ndriçimi nuk mirëmbahet, mungojnë projektet për parqe dhe çerdhe. Kjo vjen si pasojë e keqkëqerjes dhe keq planifikimit të buxhetit, çdo herë planifikohen dhe bëhen asfaltimet të dobëta, trotuaret të dobëta, ndriçim publik pa mirëmbajtje. Asfaltimet realizohen edhe në pronë private. Subvencionet 99% ndahen pa kritere, kemi promutacion të kodeve ekonomike në zbatimin e buxhetit, 1/4 e mjeteve financiare shkojnë në asfaltim dhe zhavor, nëpër lagjet e komuniteteve nuk parashihet ndonjë projekt publik, 70,000.00€ parashihen për parqe 'Te pishat' dhe vetëm 50,000.00€ në zonat tjera. Ne nuk jemi kundër këtij investimi 'Te pishat' në fshatin Sllatinë e Vogël, por kërkojmë që investimet të bëhen në mënyrë të barabartë dhe në interesin e gjithë qytetarëve. Po ashtu 130,000.00€ për kanalizime nuk mjaftojnë. Prapë nuk parashihet ndërtimi i shkollës në Nakaradë. Si përfundim, ky buxhet për

Grupin Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, nuk është i pranueshëm dhe ne nuk e votojmë aprovimin e këtij buxheti.

Remzi Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Buxhetin për vitin 2020 ne e kemi shqyrtuar edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa. Nëse e marrim në përgjithësi ky buxhet është i pranueshëm, i planifikuar mirë dhe i mbështetur në kërkesat e Ekzekutivit të Komunës që janë radhitur sipas kërkesave të qytetarëve për rregullimin e infrastrukturës. Për neve si Komunë nuk është problem ndërtimi i objekteve shkollore dhe shëndetësore, por problem mbetet pranimi i punëtorëve të rinj meqë buxheti për vitin 2020 është gjithëpërfshirës në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, propozojmë që Buxheti i Planifikuar për vitin 2020 të aprovohet.

Driton Ademi: Kjo Kornizë Afatmesme Buxhetore është e njëjtë dhe Nisma Socialdemokrate është kundër aprovimit të buxhetit. Ne e kuptojmë që, në kuptimin juridik, hartues është Ekzekutivi i Komunës, mirëpo këtu nuk ka asnjë lëvizje. Pasqyrat e auditimit çdo vit e bëjnë theksimin e çështjeve dhe evidentojnë punët dhe projektet e kryera jashtë rregullave me legjislacionin në fuqi dhe nuk ka asnjë përmirësim minimal.

Aida Alimi: Ne në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa e kemi dhënë qëndrimin tonë, ndryshimet në buxhet janë të vogla, ne çdo herë kemi kërkuar regjistrimin e popullsisë në mënyrë që të rritet numri i punëtorëve në arsim dhe shëndetësi, kemi kërkuar blerjen e mamografit, ndryshimin e mënyrës së ndarjes së subvencioneve sepse mbështetur në ekzekutimin e buxhetit në vitet paraprake ka munguar mbikëqyrja e shpenzimit të mjeteve financiare, që janë kontribut i taksapaguesve, andaj mbështetur në këto fakte Partia Demokratike e Kosovës është kundër aprovimit të këtij buxheti.

Mehdi Lahu: Unë do të ndalem tek rrethojat në rrugën 'Nënë Tereza' ku parashihet shpenzimi i mjeteve financiare në shumë prej 340,000.00€, kjo shumë është e lartë. Kjo punë ndërlidhet edhe me rregullimin e trafikut në qytetin tonë, kjo iniciativë është parashtruar nga asamblisti z. Naser Graicevci.

Nënkryetari i Komunës: Këto mjete financiare do të shpenzohen vetëm për rrethojën e rrugëve anësore nga udhëkryqi deri tek rruga e Uglarit, ndërsa plani i mobilitetit është një projekt që duhet të hartohet nga ekspertët dhe synon rregullimin e trafikut në Fushë-Kosovë.

Mehdi Lahu: Ne kërkojmë që kjo punë të rregullohet mirë dhe të mos kemi promutacion të kodeve në shpenzimin e mjeteve financiare siç ka ndodhur në vitet e kaluara sepse të gjithë e dimë që numri i banorëve nuk korrespondon me numrin e banorëve të regjistruar, andaj ne kërkojmë që të jemi më këmbëngulës në rritjen e buxhetit për arsimin dhe shëndetësinë, ku problemet janë më të mëdha.

Naser Graicevci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Është mirë që sot i kemi për shqyrtim pikat e rendit të ditës që ndërlidhen me njëra tjetrën dhe mund të analizohen. Vitin e kaluar buxheti për projekte kapitale është shpenzuar vetëm 62%, ndërsa 38% buxheti ka mbetur i pa shpenzuar, me gjithë problemet që i kemi në arsim, shëndetësi dhe fusha tjera, dhe kjo duhet të paraqes një alarm për menaxhmentin e komunës. Tani shpenzimi i buxhetit është i ulët vetëm 30% dhe deri në fund të vitit nuk do të tejkaloj 60%. Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës është përshkrues dhe

përmban shifra të cilat zbërthehen më tutje në raportin financiar për buxhetin e shpenzuar në mënyrë të kënaqshme. Unë nuk do të hyjë në shifra por do t'i vendos në pah disa çështje që për qytetarët, mendoj se janë etike siç janë investimet dhe krijimi i rregullit në arsim, shërbime publike, ku hyn rregullimi i semaforëve përgjatë hekurudhës, krijimi i ulëseve për të moshuarit nëpër disa vende, aty ku ka mundësi krijimi i oazave të gjelbërta. Auditimi i Jashtëm, komunën e kritikon se nuk e bënë trajtimin e pronës publike dhe ka disa problem të theksuara në ekzekutimin e buxhetit. Sa i përket projekteve për vitin 2020 këtu nuk kemi ndonjë kreativitet, vazhdohet me përsëritje të projekteve të njëjta, subvencionimi i bujqve prapë synohet të bëhet në të njëjtën mënyrë pa rritjen e produktivitetit dhe krijimin e kushteve për ruajtjen e produkteve, andaj ne nuk mund ta votojmë një buxhet që nuk garanton zhvillim dhe një minimum të projekteve të reja dhe kreative.

Driton Hasolli: Subjekti politikë Aleanca për Kosovën e Re e përkrah aprovimin e buxhetit të komunës për vitin 2020, sepse në të janë inkorporuar propozimet tona.

Mirvete Gërguri: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne i kemi dhënë disa vërejtje tona edhe për pastërtinë dhe sigurinë në komunikacion. Sa i përket projekteve kemi kërkuar që ato të jenë të detajuara të dihen planet për investime publike për vitin e ardhshëm, cilat rrugë do të asfaltohen në fshatin Bardh i Madh apo në ndonjë fshat tjetër.

Migjen Kolshi: Unë kam marrë pjesë në dëgjimet publike dhe propozimet për ndërtimin e sallës në fshatin Harilaç dhe rregullimin e varrezave kanë hyrë në projektet e parapara për vitin e ardhshëm.

Ali Ismaili: Planifikimi i buxhetit është i njëjtë me disa ndryshime minimale po thuajse në pesë vitet e kaluara. Unë kam dhënë sugjerimet e mia që buxheti për shëndetësi dhe mirëqenie sociale të ndahet në mënyrë të barabartë apo së paku në mënyrë të përafërt. Ne çdo vit për ndërtime dhe renovime të shtëpive i ndajmë nga 250,000.00€, për katër vite janë ndarë mbi 1 milion euro dhe kjo është një punë jo e mirë, që e vështirëson funksionimin e shëndetësisë. Nga Drejtoria e Arsimit parashihet të ndahen në vitin 2020, shuma prej 40,000.00€ për kamerat në shkolla por nuk dihet, a ndahen këto mjete financiare për fshatrat e caktuara: Miradi e Poshtme, Miradi e Epërme, Bardh i Madh apo Lismir?. Nëse i viziton shkollat ato nuk janë në gjendje të mirë. Sa i përket asfaltimeve ato bëhen pa kriteret dhe në shuma të mëdha, secilin vit për fshatra të caktuara, nuk mendohet për rregullimin e shiritave - shtegut për çiklistë. Krahësuar me të kaluarën shpenzimet për rrymë, ujë dhe mbeturina janë më të ulëta, mirëpo prapë jemi larg krijimit të një sistemi të mirëfillt të menaxhimit të shpenzimeve. Nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, planifikohen vetëm shpenzime për festivale ndërkombëtare, ndërsa për sport nuk parashihen investime që do të krijonin mundësi për të rinjtë. Shpenzimet për sport janë zero. Nëse e marrim në tërësi planifikimin e buxhetit nga shumica e Drejtorive Komunale nuk ka përmirësime, andaj ky buxhet nuk mund të përkrahët për miratim.

Nënkryetari i Komunës: Ne buxhetin e hartojmë në bazë të kërkesave të qytetarëve dhe për investime sipas nevojave, prapë duhet të bëhen asfaltime të reja dhe rregullim të rrjeteve të kanalizimeve nëpër lagje të reja. Kjo mënyrë e investimeve është e pranueshme dhe po vlerësohet drejtë nga qytetarët e komunës tonë dhe neve na mbetet që të punojmë në periudhën e ardhshme.

Sabit Bullatovci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Për mua është kënaqësi e veçantë kur ka debate, sepse ne po e bëjmë strukturimin e buxhetit me një gjithë përfshirje për vendbanimet e komunës tonë, nevoja për asfaltime dhe kanalizime ka çdo kund. Është obligim moral i secilit që të sjellë diçka me shkrim për vendbanimin e tij, por të kujdeset edhe për gjithë territorin e komunës në mënyrë që mjetet financiare të parapara për investime publike të shpërndahen drejtë. Në diskutimet tuaja ju po e theksoni se ka keqpërdorime, po akuzoni pa ndonjë fakt të mbështetur në argumente. Andaj unë ju sugjeroj dhe dua të shpreh mendimin tim personal, se në komunën tonë është punuar por edhe ne duhet të jemi vetëkritikë, kur nuk paraqesim ide dhe projekt propozime për zhvillimin e fshatrave dhe lagjeve tona.

Ali Ismaili: Unë nuk pajtohem me kritikën dhe tendencën për fajësim nga parafolësi im. Unë këtu përfaqësoi votuesit e mi dhe Partinë e Drejtësisë me një anëtar, ju jeni 12 anëtarë nga partia në pushtet dhe pesha në vendosjen e prioritetëve dhe projekteve publike nuk është e njëjtë. Unë në vazhdimësi kam paraqitur disa ide për balancimin e shpenzimeve në fusha të caktuara, por ato nuk janë marrë parasysh.

Nënkryetari i Komunës: Unë dua të sqaroj para juve se nuk dua të ndërhyjë kur ju i parashtroni propozimet tuaja, por ndërhyjë vetëm atëherë kur duhet të racionalizohet debati për një çështje të njëjtë që shpeshherë stërzgjatet pa nevojë diskutimi.

Naser Graiçevci: Ne e dimë se asamblisti z. Sabit Bullatovci ka punuar për fshatin e tij dhe aty ka realizuar disa projekte të mira, por nuk mund ta pranojmë ndërhyrjen dhe trajtimin që e bëri në diskutimin e tij paraprak. Jeta në fshatra dallon shumë nga qyteti i Fushë-Kosovës, këtu në qytet nevojat për investime janë më të shumëllojshme dhe nevojiten investime të vogla, por me një kreativitet që e funksionalizojnë jetën në një zonë të caktuar.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Ne jemi të detyruar që të kemi promutacion të shpenzimeve nëpër kode të caktuara, sepse buxheti neve na ndahet vetëm për 34000 mijë banorë ndërsa në realitet janë mbi 50000 banorë. Pas më shumë se dhjetë viteve na janë rritur 22 punëtorë në arsim dhe kjo besoj që do të na ndihmoj sado pak në punën tonë.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2020'.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', nëntë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej njëzet e pesë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2020' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2020, në shumë të përgjithshme prej 12,608,367.00€, i shpërndarë nëpër programe e nënprograme të kategorive ekonomike si vijon:
 - 1.1 Për paga dhe mëditje për 772 të punësuar në Administratën Komunale, Arsim dhe Shëndetësi, buxheti i komunës është në shumë prej: 5,602,346.00€;
 - 1.2 Për mallra dhe shërbime, buxheti i komunës është në shumë prej: 1,601,707.00€;
 - 1.3 Për shpenzime komunali, buxheti i komunës është në shumë prej: 230,000.00€;

- 1.4 Për subvencione e transfere, buxheti i komunës është në shumë prej: 299,657.00€;
- 1.5 Për shpenzime në projekte kapitale, buxheti i komunës është në shumë prej: 4,874,657.00€.
2. Vlerësimet e hershme të caktuara me kufijtë për Buxhetin e Planifikuar me Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin fiskal 2021, është në shumë të përgjithshme prej: 12,957,371.00€, me shumën e caktuar për projekte kapitale prej: 4,917,261.00€ dhe për vitin fiskal 2022, është në shumë të përgjithshme prej: 13,336,910.00€, me shumën e caktuar për projekte kapitale prej: 5,042,269.00€.

Koha për pushim 10 minuta.

Pika e katërt (4) - Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës për periudhën janar/qershor 2019.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtuim dhe analizim 'Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës për periudhën janar/qershor 2019', i cili zbërthehet në vazhdim të raportit të punës, për secilin Drejtori të Komunës.

Nënkryetari i Komunës: Unë dua t'i them disa fjalë lidhur me 'Raportin e Punës së Kryetarit të Komunës. Ne mund ta paraqesim për shqyrtim dhe analizim edhe një raport të shkurtër të përbërë vetëm prej disa faqeve, por ka qenë kërkesë e asamblistëve më herët që të kemi shënime të zgjeruara për punën, aktivitetet dhe projektet që realizohen nga komuna. Të gjitha të dhënat e prezantuara në raport i keni në formë analitike dhe përshtatëse të cilat zbërthehen me kosto financiare në mënyrë të detajuar, sipas kodeve ekonomike të shpenzimeve në raportin financiar, andaj raporti prej rreth 50 faqeve, paraqet një pasqyrë të mirë për punët e realizuara që duhet të analizohet dhe vlerësohen nga ju.

Migjen Kolshi: Prezantimi i punës në Raportin e Kryetarit të Komunës bëhet ashtu siç i konvenon drejtorive të caktuara të Komunës. Në Drejtorinë e Administratës theksohet se është mbikëqyrë sistemi elektronik i vajtje/ardhjeve në punë, kjo është rrenë sepse kjo punë nuk funksionon, ne nuk jemi të vegjël që ju të na gënjeni. Po ashtu edhe në drejtoritë tjera ka përshtatime që mendoj se u duhet një analizë për t'i verifikuar se a janë të sakta. Në raportin e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit ceket se Klubi i Futbollit 'Fushë-Kosova' ka rënë nga liga e parë e futbollit por nuk theksohet fakti se aty ka pasur shitblerje të lojës. Po ashtu unë e kam ngritur një problem ku në një lokal në Fushë-Kosovë zhvillohet prostitucioni dhe nuk janë ndërmarrë masa nga Drejtoria e Inspektoratit. Edhe një problem tjetër që i përket shitjes së cigareve me copë për nxënës, të ngritur nga unë, nuk është kujdesur fare për eliminimin e kësaj dukurie negative Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Inspektoratit.

Aida Alimi: Raporti i Kryetarit na paraqitet për shqyrtim dhe analizim, kurse Kryetari i Komunës mungon dhe nuk e respekton asamblenë komunale, për ne kjo paraqet një fyerje që i bëhet institucionit më të lartë komunal nga ana e Kryetarit të Komunës. Andaj, ne nuk do të lëshohemi fare në diskutimet lidhur me 'Raportin e Punës së Kryetarit të Komunës'.

Durim Hajra: Ne e respektojmë prezencën e Nënkryetarit të Komunës por Raporti sipas mendimit tim duhet të shënohet se është i Nënkryetarit të Komunës, meqë Kryetari i Komunës nuk merr

pjesë në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, as kur shqyrtohet raporti i tij i punës, andaj ne nuk do të marrim pjesë në diskutim, sepse kjo nuk ka kuptim.

Remzi Shala: Sa i përket 'Raportit të Punës së Kryetarit të Komunës për periudhën janar/qershor 2019', ne punën e vlerësojmë si pozitive, raporti është gjithëpërfshirës dhe voluminoz me të dhëna të zgjeruara për secilën Drejtor të Komunës, ne jemi të thirrur që të japim sugjerimet tona për përmirësime në të ardhmen, aty ku mendojmë se ndonjë punë ka ngecur.

Sabit Bullatovci: Ky raport i punës është i Kryetarit të Komunës, unë mendoj se këtu duhet të jenë prezent vartësit e tij Drejtorët e Komunës, të cilët duhet të na bindni për atë që e kanë shkruar. Unë këtë raport e kam lexuar disa herë, shpenzimet në disa fusha janë të reduktuara por edhe ju si parti politike të opozitës duhet të na bindni me kundër argumente për secilën punë apo projekt që ceket këtu dhe nuk është kryer si duhet. Ju si opozitë duhet të na bindni neve si parti më e madhe në Kuvendin e Komunës për qëndrimet e juaja, e jo vetëm të kritikoni.

Migjen Kolshi: Anëtari i Kuvendit të Komunës z. Sabit Bullatovci është duke na fyer dhe nënçmuar dy herë radhazi duke thënë se ne nuk jemi punëtorë. Ju mund të thurni lëvdata për raportin e punës, ndërsa ne i japim vërejtjet tona.

Mehdi Lahu: Meqë Raporti i punës pasqyron punën e bërë edhe sjellja e përfaqësuesve të ekzekutivit duke filluar nga Kryetari i Komunës dhe 11 Drejtorët e Komunës duhet të jetë serioze. Ne edhe nëse i theksojmë anët pozitive dhe negative nuk kemi se kujt t'i drejtohem. Unë nuk do të thellohem në diskutime, thirrjen e anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Sabit Bullatovci ne duhet ta kuptojmë si këshillë.

Sabit Bullatovci: Unë ju kërkoj falje të gjithëve, por për secilën vërejtje që e jepni përmes kritikave tuaja, ju duhet të na bindni se është reale, e jo t'i përsërisni disa herë çështjet e njëjta pa kurrfarë nevojë.

Durim Hajra: Unë e respektoj moshën tuaj, por pajtohem plotësisht me qëndrimin e anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Migjen Kolshi, se ju jeni duke na fyer. Ne e lexojmë raportin dhe i japim vërejtjet tona, ndërsa ju po thoni se unë i kam disa vërejtje por nuk i them, kjo punë nuk është në rregull.

Pika e pestë (5) - Propozim për shqyrtimin e Raportit Financiar për buxhetin e shpenzuar për periudhën janar/qershor 2019.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Raportit Financiar për buxhetin e shpenzuar për periudhën janar/qershor 2019' ftoi Drejtorin e Financave dhe Buxhetit që të na jap sqarime.

Drejtori për Financa dhe Buxhetit: Raporti Financiar për buxhetin e shpenzuar për periudhën janar/qershor 2019, është përgatitur në bazë të Ligjit për Financat Publike dhe Përgjegjësitë dhe nëntëmbëdhjetë standardet e autitimit. Buxheti i shpenzuar në administratën komunale është në shumë prej 1,690,192.13€, në arsim është në shumë prej 1,885,983.38€, në shëndetësi është në shumë 729,234.35€ dhe zyrën e Komuniteteve 13,361.58€. të hyrat vetjake janë grumbulluar në përqindje prej 61.8%.

Migjen Kolshi: Unë e falënderoj Drejtorin e Financave dhe Buxhetit që çdo herë kur shqyrtohen pikat e tij është prezent në mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe jep sqarime për shpenzimet e bëra. Mjetet financiare të shpenzuara për dreka dhe darka në Zyrën e Kryetarit janë të larta në shumë prej 4,030.00€, ndërsa për karburante 2,710.00€. Po ashtu, pyes pse janë bërë pagesat për shpenzimet e varrimit nga shkolla 'Bajram Curri'?. Cilat shpenzime hyjnë në kuadër të shpenzimeve kontraktuese tjera.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Ne e kemi pranuar se jemi të detyruar të bëjmë promutacion të kodeve ekonomike, jo nga mosdija por për arsye të pamundësisë së mbulimit të shpenzimeve në fushën e arsimit dhe të shëndetësisë, për arsye se ne jemi duke ofruar shërbime për mbi 50000 banorë. Shpenzimet për dreka zyrtare nuk janë vetëm të Kryetarit, por aty hyjnë edhe shpenzimet për çerdhen e fëmijëve 'Gëzimi Ynë'.

Mehdi Lahu: Varësisht se si i parashtrojmë në pyetjet tona dhe kërkesat për sqarimin e shpenzimeve të caktuara përfaqësuesit e Komunës e kanë arsyetimin e vet. Kërkojmë që të na sqaroni çka përfshijnë shpenzimet kontraktuese tjera. Është mirë që në të ardhmen të kemi një planifikim më të mirë dhe të mos kemi promutacion të kodeve ekonomike. Shpenzimi i buxheti është bërë 45% dhe nëse vazhdohet me këtë trend të shpenzimeve deri në fund të vitit jemi mirë.

Durim Hajra: Qëndrimin tonë si Grup Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, lidhur me shpenzimet e kemi dhënë edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa. Nëse i marrim shpenzimet për karburante ato janë të larta dhe i bie që një veturë i bënë 100 km në ditë, pastaj shpenzimet e servisimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve janë të larta 1,400.00€ deri në 2,000.00€, që nënkupton se një veturë e caktuar ka shumë defekte, këtu vlen të theksohen shpenzimet në Zyrën e Kryetarit pa hyrë në detaje më të zgjeruara nëpër kodet e drejtorive tjera komunale ku përsëritet mënyra e njëjtë e shpenzimeve.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Ju duhet ta kuptoni se mirëmbajtja e automjeteve kushton, ne i kemi autoambulancën, autobusin, kamionin dhe dy traktorë. Prandaj, për të punuar këto automjete duhet të mirëmbahen, disa prej tyre janë të vjetruara. Po ashtu i kemi edhe katër automjete të marra me qira që na janë imponuar nga niveli qendror, të gjitha komunave të Kosovës.

Sabit Bullatovci: Nëse e bëjmë një analizë të raportit financiar të shpenzimeve kemi një rënie të tyre, mirëpo ju nuk po i lexoni dhe analizoni shpenzimet për t'i krahasuar ato. Kemi një rënie të shpenzimeve të rrymës dhe ujit të cilat tani janë në nivele standarde. Nëse dikush ka informata për keqpërdorime të mjeteve financiare ju duhet t'i paraqisni ato e jo vetëm të kritikoni pa arsye.

Migjen Kolshi: Qëndrimi juaj është i kundërt me qëndrimin e Shefit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, nëse dikush preket nga vënia në pah e dukurive jo të mira nga ne si asamblistë, nëse e vërteta qëndron ndryshe personin e caktuar e mbron ligji.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për aprovimin e Raportit Financiar për buxhetin e shpenzuar për periudhën janar/qershor 2019'.

U votua me: katërmbëdhjetë vota 'për', pesë 'kundër' dhe dy abstenime, gjithsej njëzet e një anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për aprovimin e Raportit Financiar për buxhetin e shpenzuar për periudhën janar/qershor 2019' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën janar-qershor të vitit të 2019, në shumë të përgjithshme prej 4,318,771.44€.
2. Buxheti i shpenzuar sipas programeve është si vijon:
 - 2.1 Në administratën komunale, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 1,690,192.13€;
 - 2.2 Në arsim, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 1,885,983.38€;
 - 2.3 Në shëndetësi, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 729,234.35€;
 - 2.4 Në Zyrën e Komuniteteve, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 13,361.58€.

Pika e gjashtë (6) - Raporti i Auditimit të Jashtëm për vitin 2018 në Komunën e Fushë-Kosovës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Raporti i Auditimit për vitin 2018 nga Zyra Kombëtare e Auditimit, ne si Komunë e Fushë-Kosovës e kemi marrë opinionin e pakualifikuar, me theksim të çështjeve të caktuara, për të cilat janë dhënë rekomandime të cilat duhet të përmbushen nga menaxhmenti i komunës. Ftoj Drejtorin e Financave dhe Buxhetit që të na jap sqarime.

Drejtori i Financave dhe Buxhetit: Raporti i Auditimit për vitin 2018 e ka marrë një opinion të pakualifikuar me theksim të çështjeve, për të cilat ne e kemi hartuar planin e veprimit për eliminimin e të gjeturave dhe përmbushjen e rekomandimeve. Ne po na përcjellin problemet e njëjta për arsye të regjistrimit të popullsisë ku ndarja e buxhetit nuk është reale për komunën tonë, andaj po jemi të detyruar që të bëjmë promutacion të kodeve ekonomike sa i përket shpenzimeve.

Durim Hajra: Në tabelën numër 4 janë rekomandimet nga viti paraprak, ku nga 17 rekomandime nuk janë përmbushur as gjysma e tyre. Ju po thirrreni në arsyet specifike të komunës sonë, por nga paraja publike Organizatës Jo Qeveritare 'Karitasit' për projektin 'Home Care' i janë ndarë 92% të mjeteve financiare për realizimin e projektit të punësimit të përkohshëm në shëndetësi, arsim dhe administratë. Tek Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për Festivalin Ndërkombëtarë është financuar nga investimet kapitale. Nga komuna nuk lejohet as audioincizimi i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nuk ka prezencë as të mediave.

Drejtori i Financave dhe Buxhetit: Subvencionet në bujqësi bëhen në bashkëfinancim me fermerët. Ndërsa sa i përket projektit të punësimit me 'Karitasin', e kemi bërë përmes një modeli tjetër me procedurë të tenderimit. Shpenzimi për festivalin ndërkombëtarë nuk përsëritet në vitin 2019 dhe është eliminuar si rekomandim. Disa rekomandime tjera janë në zbatim e sipër.

Mehdi Lahu: Vërejtja e auditorit të përgjithshëm është se nga 17 rekomandime, dy janë zbatuar pjesërisht, pesë janë zbatuar në tërësi dhe dhjetë kanë mbetur të pazbatuara. Qiramartja përsëritet në vazhdimësi, ne sugjerojmë që të punohet në zbatimin e 12 rekomandimeve të pa zbatuara.

Nënkryetari i Komunës: Raporti i Auditimit e ka opinionin pozitiv, këtë vit i kemi vetëm tetë rekomandime. Kemi disa keq klasifikime të shpenzimeve të cilat do të mundohemi që t'i eliminojmë në periudhën e ardhshme, por e rëndësishme është që këto rekomandime nuk kanë implikime financiare.

Pika e shtatë (7) - Informatë e Drejtorisë së Arsimit për fillimin e vitit shkollor 2019-2020.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për analizë, 'Informatën e Drejtorisë së Arsimit për fillimin e vitit shkollor 2019-2020', ku shumica e të dhënave janë të njëjta me raportin e punës.

Nënkryetari i Komunës: Drejtoria e Arsimit mbështetur në kërkesat tuaj ka dashur që t'iu informoj për rrjedhën e fillimit të viti të ri shkollor 2019-2020.

Aida Alimi: Unë kam qenë pjesë e Grupit Punues që e ka bërë ndarjen e nxënësve sipas rrugëve, mirëpo tani na duhet të kërkojmë mirëkuptimin e sekretarit të shkollës për ta regjistruar një nxënës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Duhet ta keni parasysh se cilës rrugë i takon me vendbanim nxënësi i caktuar.

Aida Alimi: Këtu kemi të bëjmë me shkollën 'Mihal Grameno', ku prindërit e fëmijës e kanë pasur kontratën me qira për banesën e tyre, atyre nuk u është pranuar ai dokument.

Mehdi Lahu: Unë mendoj se nuk kemi të drejtë të ndërhyjmë në punën e shkollimit, ata duhet të respektojnë vendimin e Kuvendit dhe punën e Grupit Punues. Në shkolla ka probleme tjera, duke filluar nga gjendja e pastërtisë dhe aspekti edukativo-arsimorë, nuk është duke u bërë në mënyrën e duhur sepse mungon cilësia në mësim. Në mënyrë të heshtur edhe profesorët janë pajtuar me këtë gjendje në shkolla dhe nuk ankohen për krijimin e kushteve më të mira në shkolla.

Pika e tetë (8) - Të ndryshme.


Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Të ndryshme', ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës, që ta marrin fjalën, nëse kanë për ta ngritur ndonjë çështje për diskutim.

Sabit Bullatovci: Nga rrufeja janë dëmtuar gjashtëdhjetë drita, kërkojë që Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, që të intervenon për rregullimin e tyre.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në orën 13:05h.

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevci



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha

